

Deutsch




Shqip

Përkujdesja themelore  
në Niederösterreich

për azilkërkuesit dhe të huajt e tjerë që nuk dëbohet

## ALLGEMEINES UND ZUSTÄNDIGKEITEN


### 1. Warum gibt es die Grundversorgung?

 Um insbesondere hilfsbedürftigen Asylwerbern in Österreich ein menschenwürdiges Leben zu ermöglichen.

Die Grundversorgung ist im **NÖ Grundversorgungsgesetz** geregelt.


Das NÖ Grundversorgungsgesetz wurde im **LGBl. 9240 verlautbart**. Im Internet finden Sie dieses Gesetz unter <http://www.ris.bka.gv.at> in der Rubrik Landesrecht - geltende Fassung Niederösterreich - mit dem Suchwort „NÖ Grundversorgungsgesetz“.

### 2. Wer übernimmt für meine Grundversorgung die Kosten?

 Ihre Versorgung wird vom **Land Niederösterreich** und dem **Bundesministerium für Inneres** aus Steuermitteln der österreichischen Bevölkerung finanziert.

## INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME DHE KOMPETENCAT


### 1. Përse ekziston përkujdesja themelore?

 Që t'u mundësojë një jetë të denjë për njeriun, në veçanti azilkërkuesve në Austri që kanë nevojë për ndihmë.

Përkujdesja themelore është e përcaktuar në **NÖ Grundversorgungsgesetz (ligji i përkujdesjes themelore të Austrisë së Poshtme)**.

Ligji i përkujdesjes themelore të Austrisë së Poshtme (Niederösterreich = NÖ) është **shpallur në LGBl. 9240**. Në internet e gjeni këtë ligj në adresën <http://www.ris.bka.gv.at> në seksionin Landesrecht - geltende Fassung Niederösterreich – me fjalë kërkimi „NÖ Grundversorgungsgesetz“.

### 2. Kush i merr përsipër shpenzimet për përkujdesjen themelore për mua?

 Përkujdesja ndaj jush financohet nga **Land Niederösterreich (landi Niederösterreich)** dhe nga (**Ministria Federale e Punëve të Brendshme**) nga paratë e taksave të popullit austriak.

3. Wer entscheidet in NÖ über meine Grundversorgung?



Über die Gewährung der Grundversorgung entscheidet im Namen der NÖ Landesregierung die **Koordinationsstelle für Ausländerfragen**.

4. Wie finde ich die Koordinationsstelle?



**Koordinationsstelle für Ausländerfragen** beim Amt der NÖ Landesregierung:  
3109 St. Pölten, Landhausplatz 1, Haus 7a,  
Tel.Nr.: 02742/9005/12994, Fax: 02742/9005/15640,  
E-Mail: [post.ivw2fluechtlingshilfe@noel.gv.at](mailto:post.ivw2fluechtlingshilfe@noel.gv.at).  
Weitere Informationen finden Sie unter  
<http://www.noel.gv.at/Gesellschaft-Soziales/Soziale-Dienste-Beratung/Fluechtlingshilfe.html>.

Die Wegbeschreibung zur Koordinationsstelle für Ausländerfragen entnehmen Sie der Seite 4.

3. Kush vendos në NÖ për përkujdesjen themelore për mua?



Për ofrimin e përkujdesjes themelore, në emër të qeverisë së landit NÖ, vendos **Koordinationsstelle für Ausländerfragen (Zyra e Koordinimit për Çështjet e të Huajve)**.

4. Si mund ta gjej zyrën e koordinimit?



**Koordinationsstelle für Ausländerfragen** në zyrat e qeverisë së landit NÖ:  
3109 St. Pölten, Landhausplatz 1, Haus 7a,  
Nr. Tel: 02742/9005/12994, Faks: 02742/9005/15640,  
E-postë: [post.ivw2fluechtlingshilfe@noel.gv.at](mailto:post.ivw2fluechtlingshilfe@noel.gv.at).  
Më shumë informacione do të gjeni në adresën e internetit  
<http://www.noel.gv.at/Gesellschaft-Soziales/Soziale-Dienste-Beratung/Fluechtlingshilfe.html>.

Përshkrimin e rrugës për në Koordinationsstelle für Ausländerfragen do ta gjeni në faqen 4.

Karte – Fußweg vom Bahnhof zur Koordinationsstelle für Ausländerfragen im Regierungsviertel



Harta – Rruga në këmbë nga stacioni i trenit për në Koordinationsstelle für Ausländerfragen në bllokun e ndërtesave të qeverisë

Karte – Genauer Standort der Koordinationsstelle für Ausländerfragen beim Amt der NÖ Landesregierung im Regierungsviertel, Landhausplatz 1, Haus 7a




Harta – Vendi i saktë i Koordinationsstelle für Ausländerfragen në godinën e qeverisë së landit NÖ në bllokun e ndërtesave të qeverisë, Landhausplatz 1, Haus 7a

## Bezirke in Niederösterreich


D = Diakonie

C = Caritas




## Qarqet në Niederösterreich

5. Von wem werde ich betreut? – Hilfe bei Fragen!

 Wenn Sie in den **blau** gekennzeichneten Bezirken wohnen, ist die **Caritas** für Sie zuständig, in den **rot** gekennzeichneten ist es die **Diakonie**. Diese **Betreuungsorganisationen** besuchen Sie auch regelmäßig in den organisierten Quartieren (Pensionen). Wenn Sie Fragen haben, wenden Sie sich an die zuständigen Betreuer.

5. Kush do të kujdeset për mua? – Nëse pyesni, do të qjeni ndihmën e duhur!!

 Në rast se ju banoni në qarqet e shënuara me ngjyrë **blu**, për ju do të kujdeset **Caritas**-i, dhe nëse banoni në ato me ngjyrë **të kuqe**, është **Diakonie** ajo që do të kujdeset. Këto **organizata përkujdesjeje** ju vizitojnë gjithashtu rregullisht në banesat e organizuara (pensionet). Nëse keni pyetje, drejtojuni direkt organizatës së caktuar përkatëse.

## 6. Wo sind die Diakonie und Caritas erreichbar?



**Caritas Wr. Neustadt:** Wiener Straße 56,  
2700 Wr. Neustadt, Tel.Nr.: 02622/83020,  
Fax: DW 66, E-Mail: [post-mfb-noe@caritas-wien.at](mailto:post-mfb-noe@caritas-wien.at).

**Caritas Korneuburg:** Hauptplatz 6-7, 2100 Korneuburg,  
Tel.Nr.: 02262/62355, Fax: DW 50,  
E-Mail: [post-mfb-noe@caritas-wien.at](mailto:post-mfb-noe@caritas-wien.at).

Weitere Informationen finden Sie unter <http://www.caritas-wien.at/mobilebetreuung.htm>.

**Diakonie St. Pölten:** Josefstraße 5/4, 1. Stock, 3100 St. Pölten,  
Tel.Nr.: 02742/21438, Fax: DW 5,  
E-Mail: [noewe@diakonie.at](mailto:noewe@diakonie.at).

Weitere Informationen finden Sie unter  
<http://fluechtlingsdienst.diakonie.at/goto/de/was/Beratung/mobile-betreuungsstelle-niederoesterreich-west/besondere-aktivitaeten>.

## LEISTUNGEN

### 7. Wer kann Grundversorgung bekommen?



**Hilfsbedürftige Asylwerber** und bestimmte andere **nicht abschiebbare hilfsbedürftige Fremde**.

Hilfsbedürftig ist, wer nicht selbst für seinen **Lebensunterhalt (Wohnung, Essen, Bekleidung) sorgen kann**. Genauere Information erhalten Sie bei der Caritas oder Diakonie.

## 6. Ku mund t'i gjej zyrat e Diakonie dhe Caritas?



**Caritas Wr. Neustadt:** Wiener Straße 56,  
2700 Wr. Neustadt, Nr. Tel: 02622/83020,  
Faks: numri i brendshëm telefonik: 66, E-postë: [post-mfb-noe@caritas-wien.at](mailto:post-mfb-noe@caritas-wien.at).

**Caritas Korneuburg:** Hauptplatz 6-7, 2100 Korneuburg,  
Nr. Tel: 02262/62355, Faks: numri i brendshëm telefonik: 50,  
E-postë: [post-mfb-noe@caritas-wien.at](mailto:post-mfb-noe@caritas-wien.at).

Më shumë informacion do të gjeni në adresën e internetit  
<http://www.caritas-wien.at/mobilebetreuung.htm>.

**Diakonie St. Pölten:** Josefstraße 5/4, 1. Stock, 3100 St. Pölten,  
Nr. Tel: 02742/21438, Faks: numri i brendshëm telefonik: 5,  
E-postë: [noewe@diakonie.at](mailto:noewe@diakonie.at).

Më shumë informacion do të gjeni në adresën e internetit  
<http://fluechtlingsdienst.diakonie.at/goto/de/was/Beratung/mobile-betreuungsstelle-niederoesterreich-west/besondere-aktivitaeten>.

## PËRFITIMET

### 7. Kush mund të marrë përkujdesje themelore?



**Azilkërkuesit që kanë nevojë për ndihmë dhe të huajt e tjerë të përcaktuar që nuk dëbohen, por kanë nevojë për ndihmë.**

Person që ka nevojë për ndihmë është ai që nuk mund t'i sigurojë vetë shpenzimet e jetesës (strehimin, ushqimin, veshjen). Informacionin e saktë mund ta merrni te Caritas ose Diakonie.

## 8. Welche Grundversorgungsleistungen kann ich bekommen?

Die wichtigsten Leistungen sind:



- **Unterbringung**
- **Verpflegung**
- **Krankenversorgung**
- **Bekleidungshilfe (max. €150,- pro Jahr)**
- **Schulbedarfshilfe für schulpflichtige Schulkinder (max. €200,- pro Jahr und Kind)**
- **Taschengeld (max. €40,- pro Person und Monat)**

Bitte beachten Sie, dass die Leistungen je nach Unterbringungsform (organisiert oder privat) verschieden sein können.

Bezüglich sonstiger möglicher Leistungen oder anderer Fragen setzen Sie sich mit Ihrer Betreuungsorganisation (Caritas oder Diakonie) in Verbindung.

## 9. Bekomme ich Taschengeld?



**Grundsätzlich** können Sie **€ 40,- pro Person und Monat** bekommen, wenn Sie in einer **organisierten Unterkunft** (Gasthaus, Pension, Heim) untergebracht sind und dort kein Verpflegungsgeld ausbezahlt wird.

## 8. Cilat përfitime të përkujdesjes themelore mund të fitoj unë?

Përfitimet më të rëndësishme janë:



- **Strehimi**
- **Ushqimi**
- **Përkujdesja shëndetësore**
- **Ndihmë për veshje (maks. 150 € në vit)**
- **Ndihmë për pajisje shkollore për fëmijët që e kanë të detyrueshme shkollën (maks. 200 € në vit dhe për fëmijë)**
- **Pará xhepi (maks. 40 € për person dhe në muaj)**

Ju lutemi mbani parasysh që përfitimet mund të jenë të ndryshme në varësi të formës së strehimit (të organizuar ose privat).

Lidhur me përfitime të tjera të mundshme ose për pyetje të tjera, kontaktoni me organizatën përkatëse për përkujdesjen tuaj (Caritas ose Diakonie).

## 9. A marr unë pará xhepi?



**Në thelb** ju mund të merrni **40 € për person dhe në muaj**, kur jeni të strehuar në një **banesë të organizuar** (hotel, pension, azil) dhe atje nuk ju jepen pará për shpenzime ushqimesh.

10. Kann ich aus der Grundversorgung entlassen werden?



**Ja!** Insbesondere

- **Drohungen, Gewalttätigkeiten, unzumutbares Verhalten in Quartieren**
- **ausreichendes eigenes Einkommen**
- **Vermögen (z.B. Besitz eines Autos)**
- **rechtskräftig abgeschlossene Asylverfahren (sowohl positive als auch negative Entscheidungen)**
- **nicht genehmigter Wechsel des Quartiers**

können zur Entlassung aus der Grundversorgung führen.

11. Was kann ich tun, wenn ich aus der Grundversorgung entlassen werde?



- Sie können die zuständige Betreuungsorganisation aufsuchen, um eine Lösung des Problems zu erarbeiten.
- Wenn Sie noch Asylwerber sind, können Sie von der Koordinationsstelle für Ausländerfragen eine schriftliche Erledigung verlangen.

10. A mund të përjashtohem nga përkujdesja themelore?



**Po!** Në veçanti

- **kërcënimet, veprimet e dhunshme, sjellja e papranueshme në lagje**
- **të ardhurat personale të mjaftueshme**
- **pasuria (p.sh. zotërimi i një makine)**
- **proceset e përfunduara me fuqi ligjore të kërkimit të azilit (si vendimet pozitive, ashtu edhe ato negative)**
- **ndryshimi i paaprovuar i vendit të banimit**

mund të çojnë në përjashtim nga përkujdesja themelore.

11. Çfarë mund të bëj unë kur përjashtohem nga përkujdesja themelore?



- Ju mund të shkoni tek organizata përkatëse e përkujdesjes për ju, me qëllim që t'i japin një zgjidhje problemit.
- Nëse jeni ende një azilkërkues, ju mund të kërkoni nga Koordinationsstelle für Ausländerfragen një zgjidhje me shkrim.



## WOHNEN

12. Welche Unterbringungsarten gibt es?



- Unterbringung in **organisierten Unterkünften** (Unterbringung in einem Gasthaus, Pension, Heim)
- Unterbringung in **privaten Unterkünften** (Mietzuschuss für eine Wohnung)

13. Habe ich Anspruch auf eine bestimmte Unterkunft oder Unterbringungsart?



**Nein!**

Angebote **organisierte Unterkünfte** (Pension) **müssen Sie annehmen**. Ablehnung kann zum Verlust der gesamten Grundversorgung führen. Jeder gewünschte Wechsel in eine andere Unterkunft muss **vorher** von der Koordinationsstelle **genehmigt** werden.

14. Kann ich jederzeit die Unterkunft wechseln?



**Nein!**

Jeder Wechsel ist von der Koordinationsstelle für Ausländerfragen **vorher** zu **genehmigen**. Auch privater Wohnungswechsel muss gemeldet und genehmigt werden. Setzen Sie sich diesbezüglich im Vorhinein mit Ihrer Betreuungsorganisation in Verbindung.

## BANIMI

12. Çfarë llojesh strehimi ekzistojnë?



- Strehim në **banesa të organizuara** (strehim në një hotel, pension, azil)
- Strehim në **banesa private** (subvencion në qiranë për një banesë)

13. A kam të drejtë të kërkoj një banesë ose lloj strehimi të përcaktuar?



**Jo!**

**Ju duhet t'i pranoni banesat e organizuara** (pensionet) që ju ofrohen. Refuzimi mund të çojë në humbjen e plotë të përkujdesjes themelore. Çdo ndryshim i dëshiruar në një banesë tjetër duhet **që më parë** të jetë **aprovuar** nga Zyra e Koordinimit.

14. A mund ta ndryshoj banesën në çdo kohë?



**Jo!**

Çdo ndryshim duhet që **më parë të aprovohet** nga Koordinationsstelle für Ausländerfragen. Gjithashtu edhe ndryshimi i banesave private duhet të njoftohet më parë dhe të aprovohet. Kontaktoni paraprakisht me organizatën përkatëse për përkujdesjen tuaj lidhur me këtë problem.

15. Kann ich mir ein beliebiges Bundesland aussuchen?



**Nein!**

Mit dem Transfer aus der Erstaufnahmestelle (EAST Traiskirchen, Thalham) werden Sie einem Bundesland zugewiesen. Dieses Bundesland ist grundsätzlich für Sie zuständig. Ein Wechsel im Rahmen der Grundversorgung ist nur nach Genehmigung beider betroffenen Bundesländer möglich. Wechseln Sie ohne Genehmigung das Bundesland, können Sie Ihren Anspruch auf Grundversorgung verlieren. Informationen dazu können Sie von Ihrer Betreuungsorganisation erhalten.

16. Was muss ich bei Privatunterkünften berücksichtigen?



**Wichtig!**

Sie haben **keinen Anspruch auf Geld für eine Privatunterkunft** und brauchen daher vorher eine **Genehmigung** von der Koordinationsstelle für Ausländerfragen. Nicht genehmigte Privatunterkünfte müssen Sie vollständig **selbst finanzieren**. Die entsprechenden Unterlagen und Beratung für einen Wechsel bekommen Sie bei der Caritas und Diakonie.

15. A mund të zgjedh një land federal çfarëdo?



**Jo!**

Me transferimin nga pika e parë e pranimit (EAST Traiskirchen, Thalham) ju do të caktoheni në një land federal. Ky land është në thelb përgjegjës për ju. Një ndryshim në kuadër të përkujdesjes themelore është i mundshëm vetëm pas aprovimit të të dy landeve përkatës. Nëse e ndryshoni pa aprovimin e landit, ju mund të humbisni të drejtën për përkujdesjen themelore. Informacione për këtë pikë mund të merrni nga organizata përkatëse që përkujdeset për ju.

16. Çfarë duhet të marr parasysh për banesat private?



**E rëndësishme!**

Ju nuk keni **asnjë të drejtë për pará për një banesë private** dhe për këtë ju duhet më parë një **aprovim** nga Koordinationsstelle für Ausländerfragen.

Banesat private që nuk janë të aprovuara duhet që ju **t'i paguani vetë**. Dokumentet dhe këshillimin përkatës për një ndryshim ju mund ta merrni te Caritas dhe Diakonie.

17. Wie viel Geld bekomme ich für genehmigte Privatunterkünfte?



- Als **Einzelperson** bekommen Sie pro Monat maximal € 110,- Mietzuschuss und € 180,- Verpflegungsgeld.
- Als **Familie** bekommen Sie pro Monat maximal € 220,- Mietzuschuss, € 180,- Verpflegungsgeld für jeden Erwachsenen und € 80,- Verpflegungsgeld für jeden Minderjährigen (bis 18 Jahre).

Bitte beachten Sie, dass Sie mit dieser Unterstützung Ihre gesamten Lebenskosten bestreiten müssen (Strom, Heizung, Lebensmittel, Fahrkarten, Möbel und ähnliches kosten viel Geld)!

18. Gelten für mich Hausordnungen?



**Ja! Für organisierte Unterkünfte** gibt es eine Hausordnung der Koordinationsstelle für Ausländerfragen.

Die Nichtbeachtung dieser Hausordnung kann zur **Entlassung aus der Grundversorgung** führen.

Bei Ihrem Einzug in eine Grundversorgungsunterkunft sollten Sie die Hausordnung in einer Ihnen verständlichen Sprache erhalten und diese auch unterschreiben. In Ihrem Interesse sollten Sie Ihre Pflichten aus der Hausordnung kennen und beachten.

17. Sa pará marr unë për banesat private të aprovuara?



- Si **person i vetëm** ju merrni çdo muaj maksimumi 110 € subvencion për qiranë dhe 180 € për të blerë ushqime.
- Si **familje** ju merrni çdo muaj maksimumi 220 € subvencion për qiranë, 180 € për çdo të rritur dhe 80 € për çdo të mitur (deri në 18 vjeç) për të blerë ushqime

Ju lutemi mbani parasysh që ju duhet të përballoni të gjitha shpenzimet e jetesës suaj me këtë mbështetje (energjinë, ngrohjen, ushqimet, biletat, mobiliet dhe të ngjashme si këto kushtojnë shumë pará)!

18. A janë të vlefshme për mua rregullat e shtëpisë?



**Po! Për banesat e organizuara** ekziston një rregull shtëpie nga Koordinationsstelle für Ausländerfragen. Mos-ndjekja e këtyre rregullave mund të çojë në **përfundimin nga përkujdesja themelore.**

Gjatë zhvendosjes suaj në një banesë të përkujdesjes themelore duhet që ju t'i merrni rregullat e shtëpisë në një gjuhë që ju e kuptoni dhe t'i nënshkruani ato gjithashtu.

Është në interesin tuaj që t'i njihni dhe t'i mbani parasysh detyrimet tuaja që dalin nga rregullat e shtëpisë.

19. Wie lange darf ich von einer organisierten Unterkunft abwesend sein?



Sie haben Ihren Quartiergeber über Abwesenheiten grundsätzlich zu informieren. Bei mehrmaliger Abwesenheit wird von der Koordinationsstelle für Ausländerfragen Ihre **Hilfsbedürftigkeit in Frage gestellt**. Bei längerer Abwesenheit als 3 Tage erfolgt automatisch die Abmeldung von der Grundversorgung (außer bei gemeldetem Aufenthalt im Krankenhaus).

## RECHTLICHE ANGELEGENHEITEN

20. Was wird mir bei behördlichen Ladungen empfohlen?



**Ladungen sollten in Ihrem Interesse unbedingt befolgt werden!!!!**

Ansonsten kann es zu Nachteilen im Asylverfahren oder zur **Einstellung der Grundversorgung** führen. Werden Sie von **Asylbehörden geladen**, werden Ihnen die **Fahrtkosten ersetzt**. Setzen Sie sich bei Ladungen dringend mit der für Sie zuständigen Betreuungsorganisation in Verbindung.

19. Për sa kohë mund të qëndroj larg një banese të organizuar?



Ju duhet të njoftoni rregullisht dhënësin e shtëpisë suaj për mungesën tuaj. Në rast të mungesës së shpeshtë **do të vihet në dyshim nevoja juaj për ndihmë** nga ana e Koordinationsstelle für Ausländerfragen. Për mungesa më të gjata se 3 ditë pason automatikisht çregjistrimi nga përkujdesja themelore (përveç qëndrimit të njoftuar në spital).

## ÇËSHTJET LIGJORE

20. Çfarë më këshillohet për thirrjet zyrtare?



**Është në interesin tuaj që të gjitha thirrjet zyrtare të ndiqen patjetër!!!!**

Përndryshe ajo mund të çojë në probleme në procedurat e azilit ose në **ndërprerjen e përkujdesjes themelore**. Nëse **do të thirreni nga zyrtarët e emigracionit**, atëherë do t'ju **kompensohen shpenzimet e udhëtimit**. Kontakti me shpejtësi me organizatën përkatëse për përkujdesjen tuaj në rast të thirrjeve të tilla.

## 21. Darf ich in Österreich arbeiten?



Auch als Asylwerber unterliegen Sie dem Ausländerbeschäftigungsgesetz und **brauchen eine Beschäftigungsbewilligung.**

Eigenes Einkommen kann Auswirkungen auf die Höhe Ihrer Grundversorgung haben. Wenn Sie arbeiten und selbst Geld verdienen, müssen Sie dies aufgrund einer gesetzlichen Verpflichtung sofort der Koordinationsstelle für Ausländerfragen melden. Kommen Sie dieser Verpflichtung nicht nach, kann dies Auswirkungen auf die Art Ihrer Unterbringung haben und ist eine Strafe möglich.

## 22. Wo gibt es für mich einen Rechtsbeistand?



Es gibt mehrere Stellen und Vereine, die Sie im Asylverfahren begleiten. Die diesbezüglichen **Kontaktadressen** erhalten Sie über Ihre **Betreuungsorganisationen.**

## 23. Was soll ich der Koordinationsstelle unverzüglich melden?



**Wichtig!**  
**Insbesondere Änderung der Familienverhältnisse, Beschäftigung, Vermögen (z.B. Auto), Einkommen und Wohnungswechsel müssen gemeldet werden.**

Wenn Sie das nicht tun, ist das strafbar und kann außerdem Auswirkungen auf die Grundversorgung haben (z.B. die teilweise oder gesamte Einstellung der Geldleistungen durch die Koordinationsstelle für Ausländerfragen).

## 21. A lejohem unë të punoj në Austri?



Gjithashtu si një azilkërkues ju i nënshtroheni ligjit për punësimin e të huajve dhe **ju nevojitet një autorizim punësimi.**

Të ardhurat personale mund të kenë ndikim në nivelin e përkujdesjes themelore për ju. Kur ju punoni, ju arrini t'i fitoni vetë paratë dhe ju duhet, në bazë të një detyrimi ligjor, të njoftoni menjëherë Koordinationsstelle für Ausländerfragen. Nëse nuk veproni në përputhje me këtë detyrim, ky mund të ketë ndikim në llojin e strehimit tuaj dhe është gjithashtu i mundshëm një ndëshkim.

## 22. Ku mund të gjej një avokat për vete?



Ka shumë zyra dhe shoqata, që ju shoqërojnë në procedurat e kërkimit të azilit. **Adresat e kontaktit** lidhur me këtë problem ju mund t'i merrni nga **organizatat që përkujdesen për ju.**

## 23. Për çfarë duhet ta njoftoj unë menjëherë Zyrën e Koordinimit?



**E rëndësishme!**  
**Në veçanti duhen njoftuar ndryshimi i gjendjes civile, punësimin, pasuria (p.sh. makinë), të ardhurat dhe ndryshimi i banesës.**

Kur ju nuk e bëni këtë, kjo është e dënueshme dhe përveç kësaj mund të ketë ndikime në përkujdesjen themelore (p.sh. ndërprerja e pjesshme ose e plotë e përfitimeve të parave nga ana e Koordinationsstelle für Ausländerfragen).

## GESUNDHEIT

### 24. Bekomme ich medizinische Versorgung?



Sie werden grundsätzlich bei der Niederösterreichischen Gebietskrankenkasse **krankenversichert**. Die unbedingt **notwendige Behandlung von Krankheiten oder Notfällen** sollte jedenfalls gewährleistet sein.

### 25. Was ist wichtig, wenn ich ein Kind bekomme?



Erkundigen Sie sich beim Arzt über den **kostenlosen Mutter-Kind-Pass**. Halten Sie im eigenen Interesse die darin vorgegebenen **Untersuchungen** im angegebenen Zeitraum genau ein, um die Gesundheit Ihres Kindes sicherzustellen.



Die **Geburt** Ihres Kindes sollten Sie sofort dem Quartiergeber oder Ihrer Betreuungsperson **melden**, damit die Aufnahme Ihres Kindes in die Grundversorgung geprüft werden kann.

## SHËNDETI

### 24. A përfitoj unë përkujdesje mjekësore?



Në parim ju **do të sigurohuni për shëndetin** në Niederösterreichische Gebietskrankenkasse (sigurimet shëndetësore rajonale të Austrisë së Poshtme). **Trajtimet e domosdoshme nga spitalet ose rastet e urgjencave** duhet që të jenë të garantuara në çdo kohë.

### 25. Çfarë është e rëndësishme kur unë bëhem me një fëmijë?



Pyesni te një mjek për **Mutter-Kind-Pass (kontrolli pa pagesë nënë-foshnjë)**. Është në interesin tuaj të jeni të përpiktë siç duhet në **vizitat** e përcaktuara në orarin e caktuar aty, për të siguruar shëndetin e fëmijës suaj.




**Lindjen** e fëmijës suaj ju duhet t'ia **njoftoni** menjëherë dhënësit të banesës tuaj ose personit që përkujdeset për ju, me qëllim që regjistrimi i fëmijës suaj të mund të provohet në përkujdesjen themelore.

26. Sind Krankentransporte kostenlos?



Ein Transport ins nächstliegende Krankenhaus erfolgt **nur dann kostenlos**, wenn aus medizinischer Sicht ein liegender Transport (Tragsessel) erforderlich war. Dies muss ärztlich verordnet sein. Ist dies nicht der Fall, müssen Sie möglicherweise die Kosten selbst zahlen.



## SONSTIGES

27. Darf ich ein Auto besitzen?



Der Besitz eines Autos kann wegen des dafür erforderlichen finanziellen Aufwandes Auswirkungen auf die Hilfsbedürftigkeit und damit auf die Höhe der Grundversorgung haben und ist **meldepflichtig!**

28. Können meine Kinder in die Schule gehen?



Kinder zwischen 6 und 15 Jahren **müssen** in Österreich eine Schule besuchen. Erkundigen Sie sich bei der für Sie zuständigen Betreuungsorganisation über einen möglichen **Schulbedarfszuschuss**.

26. A janë pa pagesë transportet e të sëmurëve?



Një transportim për në spitalin më të afërt kryhet **pa pagesë vetëm atëherë** kur nga kontrolli mjekësor del që ka qenë i nevojshëm një transportim në gjendje të shtrirë. Kjo duhet që të jetë e vërtetuar nga mjeku. Nëse nuk është kështu, atëherë duhet që ndoshta ju t'i paguani vetë shpenzimet e transportimit.



## TË NDRYSHME

27. A lejohem unë të zotëroj një makinë?



Zotërimi i një makine mund të ketë ndikim në nevojën tuaj për ndihmë për shkak të shpenzimeve të nevojshme financiare dhe në këtë mënyrë në nivelin e përkujdesjes themelore dhe është i **detyrueshëm për t'u njoftuar!**

28. A mund të ndjekin shkollën fëmijët e mi?



Fëmijët midis moshës 6 dhe 15 vjeçare **duhet** që të frekuentojnë shkollën në Austri. Pyesni në organizatën përkatëse që përkujdeset për ju për një **Schulbedarfszuschuss (subvencion për materialet shkollore)**.

29. Darf ich öffentliche Verkehrsmittel kostenlos benutzen?



**Nein!**

Benützen Sie ein Verkehrsmittel ohne Fahrschein, ist dies **strafbar**. Die Geldstrafen dafür sind in Österreich sehr hoch.

Für die meisten Verkehrsmittel müssen Sie **vor** Fahrtantritt einen Fahrschein kaufen!

30. Kann ich mich zur freiwilligen Rückkehr entscheiden?



Sollten Sie sich für eine freiwillige Rückkehr in Ihr Heimatland entscheiden, setzen Sie sich bitte mit der **Koordinationsstelle für Ausländerfragen** in Verbindung. Sie wird die **notwendigen Schritte und eine entsprechende finanzielle Unterstützung einleiten**.

29. A mund ta përdor pa pagesë transportin publik?



**Jo!**

Nëse përdorni një mjet transporti pa biletë është e **dënueshme**. Për këtë veprim gjobat në Austri janë shumë të larta.

Për pjesën më të madhe të mjeteve të transportit duhet që ju të blini një biletë përpara se të udhëtoni!

30. A mund që të vendos unë për rikthimin tim vullnetar?



Nëse vendosni për një rikthim vullnetar për në vendin tuaj, ju lutemi kontaktoni me **Koordinationsstelle für Ausländerfragen**. Ajo do t'ju **orientojë për hapat e nevojshëm që duhen ndjekur dhe për mbështetjen financiare për këtë gjë**.